

Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK) është Institucion i suksesshëm Mikrofinanciar që vepron në tërë Kosovën. Nëse dëshironi të jeni pjesë e një institucioni me integritet që vendos theks të veçantë në kujdesin ndaj klientit, dhe nëse plotësoni kriteret e pozitës së përshkruar më poshtë, ftoheni që të aplikoni për:

VENDE TË HAPURA PUNE

Pozita: **Analist/e Kreditor/e**
Lokacionet: **Dega: Mitrovicë, Prishtinë 1, Deçan, Klinë dhe Xërxë**

Detyrat:

- Të gjej klientë potencial në rajonin që mbulon, dhe të krijojë marrëdhënie të shëndosha afariste me ta;
- Të bëjë analizën e kredisë, të ardhurat/shpenzimet dhe qarkullimet e parashikuara;
- Të përgadis dokumentacionin e kredive dhe të dokument garantimeve;
- Të kontrolloj shfrytëzimin e kredive, duke përfshirë këtu edhe bërjen e vizitave të rregullta të bizneseve të klientëve;
- Të monitoroj kthimin e kredive dhe të bëjë kontrollimin e delikuencës në përputhshmëri me objektivat dhe rregulloret e organizatës;
- Të ndjek zhvillimet e biznesit në rajonin që mbulon dega përkatëse dhe të krijojë marrëdhënie me biznese të reja.

Kualifikimet:

- Edukimi universitar (preferohet edukimi në ekonomi apo financa);
- Preferohet përvojë pune së paku një vit si analist/e kreditor/e për Mikro dhe NVM, në Institucione Financiare/Mikrofinanciare (e preferueshme);
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikuese, iniciativë dhe kreativitet;
- Njohuri shumë të mirë të punës me kompjuter;
- Njohuri të mira në analiza financiare dhe të programeve që përdoren në financa dhe kredidhënie për regjistrimin e të dhënave;
- Të posedojë patent shoferi;
- Aftësi që të punojë me njerëz me prejardhje dhe përkatësi nacionale të ndryshme;
- Aftësi që të punojë si pjesë e ekipit;
- Të interesuarit duhet të plotësojnë Aplikacionin për Punë. Aplikacionet mund ti merrni në zyrën e AFK-s në adresën në vijim: • Mitrovicë-Rr.Mbretëresha Teutë • Prishtina 1, Rr. Gazmend Zajmi Nr.21, • Deçan-Rr. Sali Çeku • Klinë, Rr. Sheshi Mujë Krasniqi • Xërxë, Rr. Magjistrallja -Gjakovë-Pejë, apo ta shkarkoni nga web faqja zyrtare: www.afkonline.org

Aplikacionin e plotësuar e dërgoni në e-mail adresën: recruitment.hr@afkonline.org . Në titull duhet të shkruhet pozita e punës dhe vendi.

Së bashku me aplikacion gjithashtu dorëzoni edhe një Letër Motivimi dhe CV-në tuaj.

AFK-ja mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet Kosovare.

Afati i fundit për aplikim është 21.08.2026 ora 16:00.

Shënim: Do të kontaktohen vetem kandidatët e selektuar në listë të ngushtë!